



UNIVERSITETI I TIRANES

FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA

DEPARTAMENTI I GJUHES FRENGE

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E PUNIMIT: ARSIM DHE LIDERSHIP

“MENDIMI KRITIK NE MESIMDHENIE”

PUNUAR NGA: JOEL BEDULLA

VITI: III BACHELOR

DREJTIMI: GJUHE, LETERSI DHE QYTETERIM FRANCEZ

TIRANE 2021

1 - Çfarë nënkupton termi “të menduarit kritik”?

Një nga konceptet më të diskutuara në reformën arsimore është të menduarit kritik. Themi se mendimi kritik është një lloj sjelljeje brenda së cilës individi gjendet automatikisht vetëm duke u rritur në një mjedis kulturor të caktuar. Pra një sjellje e tillë mësohet dhe praktikohet në një mënyrë jokoshiente, ose të paktën pa reflektim të madh.¹

Në mësimdhënien e gjuhës angleze si gjuhë të dytë, mendimi kritik, i mbiquajtur lexim kritik, listohet si një aftësi konjitive që duhet zotëruar nga nxënësi. Eskey dhe Grabe (1988) e përkufizojnë atë si vlerësimin e argumentave të autorit; aftësi që kërkon që nxënësi të kërkojë idenë kryesore duke skanuar tekstin për lloje specifike informacioni. Shih (1992) thotë se një nga detyrat e nxënësve që po marrin gjuhën angleze si gjuhë të huaj është: “të reagojnë në mënyrë kritike ndaj përmbajtjes”, “të mbajnë mend pika kyçe dhe detaje”, si edhe “të përmbledhin në mënyrë sintetike informacion nga leximi”.²

Autorë të tjerë si Graman (1988) dhe Wallerstein (1983), e përkufizojnë mendimin kritik si një proces demokratik të të mësuarit, ku ekzaminohen lidhjet e fuqisë dhe pabarazitë sociale. “Mendimi kritik fillon atëherë kur njerëzit [arrijnë të] bëjnë lidhjet mes jetës së tyre individuale dhe kushteve sociale.”³

Ndërsa Richard Paul e jep përkufizimin duke bërë dallimin midis një sensi të fortë të mendimit kritik dhe një sensi të dobët. Sensi i dobët varet te disa aftësi që janë të jashtme në raport me individin, ndërsa sensi i fortë bazohet te tipare që i përkasin individit tashmë brenda

¹<https://www.jstor.org/stable/3587975>? Atkinson, D., 1997. A Critical Approach to Critical Thinking in TESOL. *TESOL Quarterly*, 31(1), fq.71-94.

² <https://www.jstor.org/stable/3587485>? Benesch, S., 1993. Critical Thinking: A Learning Process for Democracy. *TESOL Quarterly*, 27(3), fq.545-548.

³ <https://www.jstor.org/stable/3587485>? Benesch, S., 1993. Critical Thinking: A Learning Process for Democracy. *TESOL Quarterly*, 27(3), fq.545-548.

karakterit të tij.⁴ Është mendimi kritik i sensit të forte që ndikohet më së shumti nga kushtet sociale, politike dhe personale të ekperiencës arsimore të dikujt.

Mendimi kritik është më shumë një praktikë sociale sesa një set i mësueshëm pedagogjik.

“Ajo që ne e quajmë ‘mendim kritik’ ose ‘analizë’ ka rrënjë të forta kulturore. Është më shumë sesa një set teknikash shkrimi dhe mendimi - është një zë, një qëndrim, një marrëdhënie me tekstet dhe anëtarët e familjes, miqtë, mësuesit, median dhe vetë historinë e një shteti. Ja pse flitet vështirë për ‘analizën kritike’, sepse është [diçka] e mësuar në mënyre intuitive. Dallohet kollaj ashtu siç dallohet një fytyrë ose një karakter, por nuk përkufizohet aq thjesht dhe nuk shpjegohet dot thjesht ndaj dikujt që është rritur ndryshe.”⁵

2 - Çfarë problemesh ka mësimdhënia aktuale?

Bruce Romanish pohon se: “...studentët nuk dalin nga [bankat e] shkollave si mendues kritikë. Kudo shohim që dalin lëndë, synimi kryesor i të cilave është formimi i aftësive të të mënduarit”.⁶ Por pavarësisht këtyre lëndëve, autori del në përfundimin se aspektet burokratike të sistemit ekzistues arsimor kanë një ndikim madhor në mendimet e të rinjve.

Walter Benjamin shprehet: “... për një fëmijë përsëritja është shpirti i lojës, asgjë nuk i jep më shumë kënaqësi sesa ta bëjë prapë... Fëmija nuk kënaqet [së luajturi] dy herë, por kërkon të njëjtën gjë sërish e sërish, njëqind ose një mijë herë.”⁷ Por kjo vlen vetëm për lojërat. Mësimi që ka në bazë përsëritjen bëhet i lodhshëm.

⁴<https://www.jstor.org/stable/23768637>? Romanish, B., 1989. The American School and Prospects for Critical Thought. *The Journal of Educational Thought (JET) / Revue de la Pensée Éducative*, 23(1), fq.52-60.

⁵<https://www.jstor.org/stable/3587975>? Atkinson, D., 1997. A Critical Approach to Critical Thinking in TESOL. *TESOL Quarterly*, 31(1), fq.71-94.

⁶ <https://www.jstor.org/stable/23768637>? Romanish, B., 1989. The American School and Prospects for Critical Thought. *The Journal of Educational Thought (JET) / Revue de la Pensée Éducative*, 23(1), fq.52-60.

⁷<https://www.jstor.org/stable/20442697>? Virno, P. dhe Ricciardi, A., 2021. Childhood and Critical Thought. *Grey Room*, (21), fq.6-12.

Një nga problemet më të mëdha sot është injorimi i impaktit që përvojat shtypëse dhe abuzuese në shkollë kanë te aftësia dhe gatishmëria e nxënësit për të dyshuar doktrinat e pranuar nga të tjerët.⁸ Fatkeqësisht, shumë programe në shkolla e minimizojnë të menduarit kritik në një listë aftësish që mund të mësohen nëpërmjet udhëzimeve, njëlloj si çdo aftësi tjetër. Akoma më keq, disa shkolla përdorin teste të standartizuara për të përcaktuar nivelin e mendimit kritik që zotërojnë studentët.

Është problematike të mendosh se shkollat do të luajnë rolin kryesor në zhvillimin e të menduarit kritik, pasi ajo që pritet prej tyre është krijimi i kushteve të nevojshme për të lejuar vazhdimësinë e hegjemonisë ideologjike.⁹

Çfarë është hegjemonia ideologjike? Është dominimi i shoqërisë nëpërmjet kalimit të besimeve, vlerave dhe ideologjisë të klasës sociale që është në kontroll të klasat poshtë saj, në mënyrë që këto besime, vlera dhe shpjegime të pranohen si norma universalisht të vërteta. Shembull i kësaj është anashkalimi i historisë reale të skllavërisë/Holokaustit ose dhënia e një historie “të sheqerosur”, e cila ka për qëllim fshirjen e së shkuarës për të ruajtur mbarëvajtjen e strukturave ekzistuese. Shembuj të tjerë janë të mësuarit se Kolombi e zbuloi Amerikën¹⁰, se Dielli ngrihet nga Lindja¹¹ ose që Amerika u themelua si shtet i Krishterë¹². Hegjemonia ideologjike ndodh kur individi merr pjesë në përforcimin e strukturave dhe moraleve, edhe kur ato janë të dëmshme për minoritetet dhe grupet e pafuqishme.

⁸ <https://www.jstor.org/stable/23768637>? Romanish, B., 1989. The American School and Prospects for Critical Thought. *The Journal of Educational Thought (JET) / Revue de la Pensée Éducative*, 23(1), fq.52-60.

⁹ <https://www.jstor.org/stable/23768637>? Romanish, B., 1989. The American School and Prospects for Critical Thought. *The Journal of Educational Thought (JET) / Revue de la Pensée Éducative*, 23(1), fq.52-60.

¹⁰ Strauss, V., 2013. *Christopher Columbus: 3 things you think he did that he didn't*. [online] The Washington Post. Marrë nga: <<https://www.washingtonpost.com/news/answer-sheet/wp/2013/10/14/christopher-columbus-3-things-you-think-he-did-that-he-didnt/>>.

¹¹ Vecchiato, A., 2018. *Do the Sun and Moon Really Rise in the East?*. [online] Sky & Telescope. Marrë nga: <<https://skyandtelescope.org/astronomy-resources/sunrise-moonrise-east/>>.

¹² Flax, B., 2012. *Was America Founded As A Christian Nation?*. [online] Forbes. Marrë nga: <<https://www.forbes.com/sites/billflax/2012/09/25/was-america-founded-as-a-christian-nation/?sh=642e6c6a4e7b>>.

Ky argument u theksua nga Justice William J. Brennan, i cili tha se shkollat rrezikojnë të bëhen “totalitare”. Ai paralajmëroi kundër shkollave që sillen si “polica mendimi” dhe që i transformojnë studentët në “marrës të pakundërshtueshëm të asaj që Shteti zgjedh t’u komunikojë” (*Text of the Ruling*, 20 Janar, 1988, fq. 21.)

Ka shumë tregues që e mësojnë studentin të mos jetë në kontroll të mendimeve të tij. Fokusi që shkollat i japin përgjigjes së saktë e formon studentin në mënyrë që të mendojë vetëm për përgjigjen që pritet prej tij, jo atë që ai beson vërtet. Studentët i janë adaptuar jetës së shkollës; një jetë e cila kërkon që studenti të jetojë nën survejimin e fjalëve dhe veprave të tij nga ana e mësuesve. (Jackson, 1968)

Liria e mendimit është strumbullari i mendimit kritik. Në mungesë të sinqeritetit intelektual të gjithsecilit, nuk mund të flasim për mendim kritik të mirëfilltë. Në fakt, duke vëzhguar funksionin e shkollave, Hitleri doli në përfundimin se ata në pushtet kanë fatin e mirë që njerëzit nuk mendojnë për veten e tyre.¹³ Elementet autoritare të mjedisit arsimor krijojnë një individ që i nënshtrohet autoritetit dhe i pranon besimet dhe opinionet me detyrim; elemente që janë pengesë ndaj zhvillimit të mendimit individual të pavarur dhe kapaciteteve kritike.¹⁴

Shumë studentë, edhe pse mund të jenë në dijeni të varfërisë që i rrethon, u mungon njohuria për të analizuar arsyet e kësaj varfërie. Pa një njohuri të tillë, ata mund të besojnë gabimisht se fajin e ka individi dhe jo mungesa e mundësive të punësimit ose racizmi sistemik.¹⁵ Një student ekselent mund sërish të mos jetë në gjendje të dallojë ligjet dhe politikat qeveritare që krijojnë dhe ruajnë kushtet në të cilat ai jeton.

3 – Kurrikulat janë të gjitha politike

¹³ Miller, A., 1983. *For your own good*. New York: Farrar Straus Giroux, fq.xix.

¹⁴ Eliot, C., 1982. Wherein popular education has failed. *Forum*, 14, fq.425-426.

¹⁵ <https://www.jstor.org/stable/42979468>? Brock, R., 2007. Becoming Whole Again through Critical Thought: A Recipe. *Counterpoints*, 306, fq.223-231.

Sarah Benesch e parashtron pyetjen në mënyrë të mrekullueshme: "...Nga ndryshon mendimi kritik nga ai jokritik? A është një set veprimesh dhe aftësish logjike? Apo është procesi i vënies në pikëpyetje të status quo-së dhe të njohurisë dhe rendit shoqëror ekzistues?"¹⁶

Mendimi kritik është kërkimi për të zbuluar rrënjët sociale, historike dhe politike të njohurisë që kemi në dispozicion sot, me qëllim transformimin e shoqërisë. Në këtë aspekt, mund të themi se menduesi kritik është ai që fokusohet te pabarazitë e shoqërisë.

Disa mund ta shohin këtë formë mësimdhënieje si "politike", por sipas Cummins (1989), të gjitha kurrikulat janë politike¹⁷, sepse në thelb ato e inkurajojnë nxënësin që të pranojë status quo-në ose që ta hedhë poshtë. Është e natyrshme të pyesim "Përse duhet që të menduarit kritik të ketë një rol kryesor në kurrikulën arsimore?". Sepse ai shihet si kusht për të pasur pjesëmarrje aktive në një komunitet demokratik.¹⁸ Pra arsimimi në shkollë duhet të jetë kryesisht arsimimi i individit si qytetar.

4 - A është faji i mësuesve apo i institucionit?

Mësuesit e marrin autoritetin nga fuqia që u jepet me ligj nga institucioni. Fatkeqësisht kurrikulat i japin mësuesit shumë pak autonomi dhe autenticitet në mënyrën e dhënies së informacionit, duke e përdorur mësuesin si një pjesë shahu që lëvizet drejt drejtimit të dëshiruar.¹⁹ Ideja është që mësuesit paguhen për të mësuar, jo për të menduar. Dhe meqënëse struktura e punës së mësuesit ndikohet nga elemente burokratike, edhe ata vetë e "fikin" mendimin kritik, pavarësisht aftësive që zotërojnë ose përgatitjes së tyre profesionale (Frymier, 1987).

¹⁶ <https://www.jstor.org/stable/3587485>? Benesch, S., 1993. Critical Thinking: A Learning Process for Democracy. *TESOL Quarterly*, 27(3), fq.545-548.

¹⁷ <https://www.jstor.org/stable/3587485>? Benesch, S., 1993. Critical Thinking: A Learning Process for Democracy. *TESOL Quarterly*, 27(3), fq.545-548.

¹⁸ <https://www.jstor.org/stable/23768637>? Romanish, B., 1989. The American School and Prospects for Critical Thought. *The Journal of Educational Thought (JET) / Revue de la Pensée Éducative*, 23(1), fq.52-60.

¹⁹ <https://www.jstor.org/stable/23768637>? Romanish, B., 1989. The American School and Prospects for Critical Thought. *The Journal of Educational Thought (JET) / Revue de la Pensée Éducative*, 23(1), fq.52-60.

Nuk është habi, atëherë, që mësuesit konsiderohen si “menaxherët e klasës”.²⁰ Mundësitë për dialog shfrytëzohen në atë mënyrë, që diskutimi i grupit të mbahet në një drejtim dhe mësuesi të sigurohet që ata të mos dalin ‘nga tema’.

Kjo lloj ‘pedagogjie’ i bën mësuesit që ta ushtrojnë punën e tyre në një mënyrë që i mëson studentët të dëgjojnë autoritetin zyrtar, të tolerojnë mërzinë, dhe të pranojnë që vetëm të pushtetshmit kanë të drejtën për të qenë arbitrat përfundimtarë të njohurisë dhe së vërtetës.²¹

Kurrikula e programuar i kontrollon mësimdhënësit duke i konsideruar si të paaftë për të marrë vendime arsimore. Urdhrat vijnë nga autoritete jashtë klasës, edhe pse ato nuk i njohin as mësuesit, as nxënësit.²²

Institucionet arsimore janë në thelb autoritare. Kjo nuk do të thotë se çdo lloj autoriteti është në kundërshtim me mendimin kritik. Një autoritet natyral dhe i fituar vetë, domethënë autoritet që merret nga inteligjenca, përvoja dhe njohuria superiore e dikujt do të përshtatej më së miri në klasë. Por siç e dimë, kjo nuk është karakteristike në shkollën moderne.²³

Mësimdhënia është e konceptuar në këtë mënyrë: Mësuesi flet, ndërsa studenti ka rol pasiv, të paktën derisa vjen data e testimit ku ai vlerësohet në bazë të memorizimit që ka bërë. E gjitha kjo rezulton në një sistem që i penalizon shumë studentë që janë mendimtarë të mirë por karakterizohen si dembelë, vetëm sepse ata nuk e besojnë kollaj përmbajtjen e librit dhe ngaqë kërkojnë prova të tjera.

4.1 - Çfarë mund të bëjë mësuesi për të integruar mendimin kritik në klasë?

²⁰ <https://www.jstor.org/stable/23768637>? Romanish, B., 1989. The American School and Prospects for Critical Thought. *The Journal of Educational Thought (JET) / Revue de la Pensée Éducative*, 23(1), fq.52-60.

²¹ Denscombe, M., 1982. The hidden pedagogy and its implications for teacher training. *British Journal of Sociology of Education*, 3, fq.249-265.

²² Smith, F., 1986. *Insult to intelligence*. New York: Arbor House.

²³ <https://www.jstor.org/stable/23768637>? Romanish, B., 1989. The American School and Prospects for Critical Thought. *The Journal of Educational Thought (JET) / Revue de la Pensée Éducative*, 23(1), fq.52-60.

Mësuesve po u kërkohet që të zhvillojnë më shumë sesa vetëm aftësitë bazë nëpër klasat e tyre.²⁴ Atëherë si mund që mësuesit të ndihmojnë në kultivimin dhe zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve të tyre?

Pyetjet duhet të luajnë një rol më primar në mësimdhënie. Aschner (1961) e quante mësuesin “një pyetjebërës profesional” dhe thoshte se bërja e pyetjeve është “një nga mënyrat ... me anë të së cilës mësuesi stimulon mendimin dhe mësimin e studentëve.” Në fakt, një shekull më parë, Stevens (1912) vlerësoi se 4/5 e kohës në shkollë zihej nga pyetje-përgjigje.²⁵ Megjithatë, është thelbësore që individi të dijë cilat janë pyetjet që duhen bërë. Jo çdo pyetje është e vlefshme dhe ka nevojë për përgjigje. Ekzistojnë pyetje pa përgjigje dhe pyetje me përgjigje të komplikuar.

Ashtu siç pohojnë Simon, Dippo, dhe Schenke, “Përvoja nuk duhet pranuar kurrë në mënyrë jokritike. Shkolla është një vend ku duhet të eksplorohej karakteri problematik i eksperiencës.”²⁶ Kjo tregon se roli i mësuesit nuk është vetëm ai i ndërmjetësuesit apo negociuesit, por përkundrazi, ajo është që t’i drejtojë nxënësit nëpërmjet një procesi ku eksperiencat krahasohen dhe përbashkësia e tyre analizohet. Në qendër të një klase ku ndërveprohet, duhet të ketë me doemos analizë kritike të kontekstit social të jetës së nxënësit, dhe jo pranim të verbër.

Problemi kryesor në prezantimin e praktikave sociale në klasë është vështirësia e tyre për t’u mësuar. Kjo sepse nuk janë koncepte seriozisht të teorizuara (që mund të përgjithësohen) por ekzistojnë në nivelin e ‘sensit komun’. Atëherë çfarë mbetet për t’u bërë?

²⁴ <https://www.jstor.org/stable/1476693>? Lewis, A. dhe Smith, D., 1993. Defining Higher Order Thinking. *Theory Into Practice*, 32(3), fq.131-137.

²⁵ <https://www.jstor.org/stable/1169463>? D. Gall, M., 1970. The Use of Questions in Teaching. *Review of Educational Research*, 40(5), fq.707-721.

²⁶ <https://www.jstor.org/stable/3587485>? Benesch, S., 1993. Critical Thinking: A Learning Process for Democracy. *TESOL Quarterly*, 27(3), fq.545-548.

Krijimi i një klubi libri është një ide e shkëlqyer, sepse “të gjithë kanë mundësi të japin mësim dhe të mësojnë nga të tjerët”.²⁷ Rochelle Brock thotë se kur punon me studentët e saj për çështje që janë të vështira për t’u kuptuar, ajo u kërkon atyre që të krijojnë një dramë me dialog, njësoj si metoda Sokratike e të dialoguarit, dhe personazhet përfaqësojnë konfuzionin që studenti ndjen në lidhje me temën. Të shkruarit në dialog i ndihmon studentët që t’i flasin vetes, të dyshojnë mbi ato që kanë shkruar, dhe të mendojnë më thellë mbi problemet që diskutohen.²⁸

Në përfundim të këtij ushtrimi, mësuesi mund të caktojë disa studentë që të performojnë dramën e tyre përpara klasës, ose mund të performohen të gjitha dramat në një event në fund të vitit.

Dialogu i qëllimshëm midis mësuesve dhe nxënësve shihet si themel i zhvillimit të mendimit kritik nga të gjithë teoristët modernë.²⁹

5 - Përfundime

Të zotërosh mendim kritik do të thotë të shohësh të gjitha anët e një argumenti, për të krijuar mendimin tend personal. Do të thotë të ekzaminosh me imtësi mënyrën sesi truri yt punon në dallimin e supozimeve të gabuara. Mendimi kritik të lejon që të thuash “E kam gabim” në mënyrë të sigurtë. Është ai që bën dallimin mes opinionëve dhe fakteve, prandaj është i domosdoshëm në ndalimin e përhapjes së pseudoshkencës dhe besëtytnive. Por siç e kam demonstruar më sipër, mendimi kritik nuk është diçka që mësohet; ai është si një muskul që mund të ushtrohet dhe zhvillohet vetëm nga përpjekja e sigurtë e nxënësit, i cili duke dashur që të jetë sa më objektiv, është i aftë të dallojë proceset e veta mendore dhe të kritikojë

²⁷ <https://www.jstor.org/stable/26890964>? F. Hess, G., Hunter Schwartz, M. and Levit, N., 2018. Fifty Ways to Promote Teaching and Learning. *Journal of Legal Education*, 67(3), fq.696-733.

²⁸ <https://www.jstor.org/stable/42979468>? Brock, R., 2007. Becoming Whole Again through Critical Thought: A Recipe. *Counterpoints*, 306, fq.223-231.

²⁹ <https://www.jstor.org/stable/23768637>? Romanish, B., 1989. The American School and Prospects for Critical Thought. *The Journal of Educational Thought (JET) / Revue de la Pensée Éducative*, 23(1), fq.52-60.

mendimet në mënyrë introspektive. Mësuesi duhet t'i kërkojë nxënësve që të lexojnë mes rreshtave, duke krahasuar dhe kontrastuar informacionin e ri me atë që është marrë më parë. Është e rëndësishme që ata të dinë si dhe pse filluan që të besojnë diçka. Nxënësit duhet të inkurajohen që të mësojnë në mënyrën që atyre u përshtatet më së miri, pa u imponuar nga mënyrat e organizimit të mësuesit. Kjo është veçanërisht e vërtetë në universitet, ku pedagogu duhet të jetë një aksesor. Roli i tij është që të bëjë pyetje të qëllimshme për të provokuar dialog frytdhënës në klasë.

BIBLIOGRAFIA

Atkinson, D., (1997). A Critical Approach to Critical Thinking in TESOL. *TESOL Quarterly*, 31(1), fq.71-94. Marrë më 30 Maj 2021, nga <https://www.jstor.org/stable/3587975>

Benesch, S., (1993). Critical Thinking: A Learning Process for Democracy. *TESOL Quarterly*, 27(3), fq.545-548. Marrë më 24 Maj 2021, nga <https://www.jstor.org/stable/3587485>

Brock, R., (2007). Becoming Whole Again through Critical Thought: A Recipe. *Counterpoints*, 306, fq.223-231. Marrë më 29 Maj 2021, nga <https://www.jstor.org/stable/42979468>

D. Gall, M., (1970). The Use of Questions in Teaching. *Review of Educational Research*, 40(5), fq.707-721. Marrë më 24 Maj 2021, nga <https://www.jstor.org/stable/1169463>

E. Pingry, R., (1951). Critical Thinking—What Is It?. *The Mathematics Teacher*, 44(7), fq.466-470. Marrë më 30 Maj 2021, nga <https://www.jstor.org/stable/27953860>

F. Hess, G., Hunter Schwartz, M. and Levit, N., (2018). Fifty Ways to Promote Teaching and Learning. *Journal of Legal Education*, 67(3), fq.696-733. Marrë më 30 Maj 2021, nga <https://www.jstor.org/stable/26890964>

Lewis, A. dhe Smith, D., (1993). Defining Higher Order Thinking. *Theory Into Practice*, 32(3), fq.131-137. Marrë më 29 Maj 2021, nga <https://www.jstor.org/stable/1476693>

Romanish, B., (1989). The American School and Prospects for Critical Thought. *The Journal of Educational Thought (JET) / Revue de la Pensée Éducative*, 23(1), fq.52-60. Marrë më 30 Maj 2021, nga <https://www.jstor.org/stable/23768637>

Virno, P. dhe Ricciardi, A., (2021). Childhood and Critical Thought. *Grey Room*, (21), fq.6-12. Marrë më 29 Maj 2021, nga <https://www.jstor.org/stable/20442697>